

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

# PROGRAMI I LËNDËS AFTËSIM TEKNOLOGJIK

SHKALLA E TRETË

Qershori 2014

## **Përmbajtja e Programi**

- I. Hyrje .....
- II. **Korniza konceptuale e programit**
  - 1. Qëllimet e programit të Aftësimit teknologjik .....
  - 2. Lidhja e kompetencave kyçë te Aftësimit teknologjik me kompetencat e fushës dhe fushat e tjera .....
  - 3. Lidhja e “Aftësimit praktik teknologjik” me temat ndërkurrikuare .....
  - 4. Lidhja e “Aftësimit praktik teknologjik” me fushat e tjera kurrikulare .....
  - 5. Kompetencat e fushës dhe tematikat e saj .....
  - 6. Ndarja e peshave për tematikë për secilën klasë.....
- III. **Përmbajtja e shkallës së tretë**
  - 1. SHKALLA E TRETË.....
    - 1.1 TEMATIKA : **GATIMI DHE RUAJTJA E USHQIMEVE** .....
    - 1.2 TEMATIKA: **MIRËMBAJTJA E MJEDISIT SHTËPIAK, KOPSHTIT** .....
    - 1.3 TEMATIKA: **TEKSTILET DHE MIRËMBAJTJA**
- IV. Udhëzime metodologjike .....
- V. Udhëzime për vlerësimin .....
- VI. Materiale dhe burime mësimore.....

## **Tabelat dhe digramat**

- Digrama 1 Korniza konceptuale e programit .....

Digrama 2 Rezultatet e të nxënësit të komptencave kyçë që realizohen nëpërmjet Aftësimit praktik teknologjik ” për shkallën e parë e të dytë .....

Digrama 3 Lidhja ndërmjet “Aftësimit praktik teknologjik” dhe fushave të tjera.....

Digrama 4 Kompetencat e Aftësimit teknologjik dhe tematikat e lendes.....

Tabela 1 Kompetencat e fushës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të Aftësimit teknologjik 12

Tabela 2 Orë të sugjeruara për çdo tematikë..... 14

## I. Hyrje

Teknologja është një formë e veçantë e veprimtarisë njerëzore. Sot në botë ndeshesh me shumë lloje teknologjish dhe çdo ditë njerëzit ndërveprojnë në të gjitha mjediset duke përdorur materialet, mjetet dhe proceset e duhura në përgjigje të plotësimit sa më mirë të nevojave dhe dëshirave të tyre.

Arsimi teknologjik, si një fushë e kurrikulës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, zhvillon te nxënësit aftësi për t'u përballur me sfida që lidhen me funksionimin e tyre si qytetarë në këtë mjedis teknologjik. Ai integron njojuritë, shprehitë dhe qëndrimet e duhura për tu përshtatur në mjedisin teknologjik ku jetojmë, për të analizuar, konceptuar dhe përdorur sisteme të ndryshme teknologjike, për zgjidhjen e problemeve teknologjike, për prodhimin apo përpunimin e produkteve, për kryerjen e shërbimeve me mjete teknologjike etj.

Nxënësit, gjithashtu, analizojnë dhe vlerësojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë, individit dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata aftësohen të bëjnë gjykime të drejta mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Programet e “Aftësimit praktik teknologjik” përqëndrohen mbi veçoritë njoħe se, psikologjike e sociale të nxënësve, duke ofruar mundësi të aftësimit teorik dhe praktik të tyre, si dhe në formim të kompetencave të vlefshme për gjatë gjithë jetës. Këto programe janë konceptuar si pararendëse të programeve të Arsimit të Mesëm të Ulët, duke përfshirë në to përvoja praktike , si dhe njoħuri në fushën e teknologjisë, të cilat u japid mundësi nxënësve të aftësohen e të jenë të përgatitur për nivelet më të larta arsimore.

Programet e “Aftësimit teknologjik”, e konsiderojnë nxënësin si individ dhe njëkohësisht si pjesë aktive të grupit, si dhe ofrojnë mundësi të shumta për integrim kroskurikular. Përvojat që përftohen nga kjo lëndë mësimore mund të transferohen e përdoren lehtësит dhe në mënyrë produktive edhe në lëndët e tjera duke mundësuar pasurimin e informacionit teorik dhe të kulturës së përgjithshme.

## **II. Korniza konceptuale e programit**


Hartimi i programit lëndor derivon nga disa dokumente të tjera zyrtare kurrikulare: **Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar (KK)**, **Kurrikula bërthamë (KB)** dhe **Plani Mësimor i arsimit bazë (PM)**, të cilat do të shoqërohen me udhëzuesit kurrikularë dhe dokumente të tjerë në ndihmë të mësuesve për zbatimin sa më korekt të tij.

Si i tillë ky dokument i adresohet:

- **Nxënësit**, në zhvillimin e kompetencave kyçë të nxënësit dhe kompetecave të fushës së Teknologjisë dhe të lëndës “Aftësim praktik teknologjik”, në mënyrë që ata të përballojnë sfidat e jetës dhe të integrohen lehtësisht në shoqëri;
- **Mësuesit**, në planifikimin dhe realizimin me sukses të procesit mësimor, në realizimin e punës planifikuese dhe zbatuese të veprimtarisë mësimore në shkollë dhe jashtë saj;
- **Prindërit**, në njohjen me kriteret e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme të arritjeve të fëmijëve të tyre në periudha të caktuara kohore, në përputhje me kompetencat që ata shfaqin në situata të ndryshme dhe në harmoni me rezultatet e të nxënësit për fushë dhe shkallë kurrikulare;
- **Hartuesve të materialeve ndihmëse** për mësuesit dhe teksteve mësimore për nxënësit.

Programi i lëndës “Aftësimi praktik teknologjik” ka në thelb të tij realizimin e kompetencave kyçë të nxënësit dhe kompetencave të fushës duke paraqitur mënyrën sesi reazlohen këto kompetenca **nëpërmjet tematikave të përcaktuara**. Ky program është konceptuar në tri tematika, emërtimi i të cilave është bërë në përshtatje me përbajtjen e tyre. Gjithatë për secilën tematikë është përcaktuar numri minimal i orëve për realizimin e kompetencave, duke krijuar njëkohësisht mundësinë që mësuesi të jetë i lirë në rritjen e këtij numri, sipas rastit.

**Digrama 1 Korniza konceptuale e Programit**



## **1. Qëllimet e programit të “Aftësimit teknologjik”**

### **1.1.QËLLIMI I FUSHËS TEKNOLOGJI**

- Të kontribuojë në një edukim të balancuar, duke iu dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që do t'u krijojë mundësi atyre të fitojnë një grup njojurish, kuptimesh, aftësish njoħe se e përpunuese dhe kompetenca të thjeshta, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesemarrës në një botë teknologjike;
- T'u krijojë mundësi nxënësve të integrojnë këto njoħuri dhe shkatħesi/shprehi, së bashku me cilësitë pér hulumtim dhe mendim reflektiv, pér gjetjen e zgjidhjeve me vëmendjen e duhur ndaj çështjeve të shëndetit dhe sigurisë;
- Të lehtesojë zhvillimin e një sérë aftësive të komunikimit, që do t'i nxisin nxënësit të shprehin aftësitë e tyre krijuese në mënyrë praktike dhe me imaginatë, duke përdorur varietet formash: fjalë, grafikë, modele etj.;
- Të sigurojë një kontekst, në të cilin nxënësit mund tē zbulojnë dhe vlerësojnë ndikimin e teknologjive në ekonomi, në shoqëri dhe në mjedisin pérreth.

### **1.2. Qëllimi i lëndës**

Kjo lëndë ka pér qëllim tē zhvillojë te nxënësi aftësitë pér tē njoħur, eksploruar dhe analizuar sisteme tē thjeshta teknologjie, kjo, pér tē lehtesuar përshtatjen e tyre me mjedisn teknologjik që i rrethon.

Pér më tepér, kjo lëndë i ndihmon nxënësit pér tē planifikuar, projektuar dhe zhvilluar praktikisht mjete, metoda apo procese tē thjeshta teknologjike, si dhe pér tē bërë vlerësimin e produktit përfundimtar.

Aftësitë e përfshira do tē zhvillohen në mënyrë progresive, ku nxënësit orientohen në zbatimin e fazave tē përcaktuara pér zgjidhjen e problemeve tē thjeshta teknologjike.

Përfshirja në hulumtimin, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e veprimtarive apo të produkteve të marra nga situata të përditshme, do të rrisin të kuptuarit dhe zgjojnë interesin e nxënësve për këtë fushë të veprimtarisë njerëzore.

Veprimtaritë teknologjike të nxënësve mbështeten duke përdorur edhe TIK-un në regjistrimin, analizimin dhe paraqitjen e informacionit, në nxitjen e hetimeve, analizimin e provave etj.

## 2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Termi “kompetencë” i referohet një niveli të caktuar të njojurive dhe aftësive që mundësojnë dikë për të vepruar në një shumëllojshmëri të gjerë të situatave. Kompetencat përcaktohen si njouri, shkathësi dhe qëndrime që një nxënës duhet t’i fitojë gjatë një procesi mësimor. Kompetenca demostrohet nga nxënësi (*njouri*), bazohet në përformancën e tij (*aftësi*) dhe në perspektivën e sjelljes (*qëndrim*).

Të mësuarit e Aftësimit teknologjik është e bazuar në **kompetenca**. të cilat fokusohen kryesisht tek eksperiencat psiko-motore të moshës për t’i përcaktuar e zhvilluar ato. Në këtë lëndë janë përcaktuar rezultatet mësimore të cilat duhet t’i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme. Organizimi i mësimit përqendrohet në atë *çfarë duhet të dinë e të bëjnë* nxënësit dhe në atë që duhet të jenë të gatshëm *të realizojnë*.

Programi i “Aftësimit praktik teknologjik” synon të njoë dhe aftësojë nxënësit të eksplorojnë, vlerësojnë, planifikojnë dhe zbatojnë veprimtari teknologjike që lidhen me materialet tekstile, mjedisin shtëpiak, kopshtin, ushqimet, duke i parë ato në apektin teknologjik dhe ekonomik dhe duke marrë si shembull veprimtaritë e përditshme jetësore

Realizimi i Kompetencave Kyçe të Kornizës Kurrikulare (“**K4**”)<sup>1</sup> gjatë procesit mësimor, kërkon që mësuesi të koordinojë kompetencat kyçe, me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë

<sup>1</sup> K4 Kompetenca Kyçe të Kornizës Kurrikulare

metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetencë dhe rezultati të të nxënësit.

### **3. Lidhja e “Aftësimit teknologjik” me temat ndërkurrikuare**

Aftësimit teknologjik ndërlikohet me të gjitha fushat tjera, i plotëson dhe plotësohet nga ato për shkak të natyrës komplekse dhe rëndësise që ka. Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare do të ndihmojë zhvillimin dhe plotësimin e përmbajtjes së fushës për arritjen e të gjitha kompetencave kyç të kurrikulës.

### **4. Lidhja e “Aftësimit teknologjik” me fushën e teknologjisë dhe me fushat e tjera kurrikulare**

Lidhja midis fushave të ndryshme kurrikulare po rriten gjithnjë e më shumë, dhe kjo jo vetëm prej natyrës kroskurrikuare të njojurive që tashmë sistemi edukativ ofron, por edhe sepse është në interesin e të gjithëve për të bërë më të mirën për një edukim sa më të mirë të nxënësit, pasi e ndihmon atë të kutojë, të përforcojë dhe zbatojë në praktikë njojuritë e fituara.

Lënda “Aftësimi praktik teknologjik” përdor njojuritë dhe aftësitë që nxënësit kanë marrë në fushën e “Shkencave”, të “Shkencave shoqërore”, në lëndën e “Artit pamor”, si dhe në lëndën e “TIK-ut”.

## **5. Kompetencat e fushës dhe tematikat e saj**

### ***TEMATIKATE FUSHËS DHE PËRSHKRIMI I TYRE***

- Teknologjia dhe bota e kompjuterit**

Nxënësit përkufizojnë teknologjinë dhe sistemet teknologjike dhe analizojnë marrëdhënet dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues, gjithashtu ata zhvillojnë aftësitë e përdorimit fillestar të kompjuterit, njihen me pjesët përbërëse të tij, dhe e përdorin kompjuterin për zhvillimin e kompetencës digitale në të gjitha lëndët.

- Përpunimi digital i të dhënave**

Nxënësit përdorin mjetet digitale për të mbledhur, analizuar, vlerësuar, përpunuar dhe raportuar informacione nga burime të ndryshme elektronike, të cilat janë në përshtatje me moshën e nxënësve dhe me qëllimin e detyrate.

- Komunikimi grafik**

Nxënësit lexojnë dhe interpretojnë skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta teknike, si dhe përdorin mënyra të thjeshta të komunikimit grafik për të prezantuar ide dhe paraqitur objekte të thjeshta teknike.

- Strukturat dhe materialet teknologjike**

Nxënësit dallojnë materialet teknologjike të llojeve të ndryshme, përshkruajnë vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike kryesore në sistemet teknologjike të sotme, gjithashtu ata tregojnë llojet tipike të strukturave teknologjike si pjesë e sistemeve teknologjike

- Teknologjia dhe veprimtaria ekonomike**

Nxënësit analizojnë ndikimin e teknologjisë në veprimtaritë ekonomike, si dhe planifikojnë e realizojnë produkte dhe shërbime të thjeshta, me përdorimin e materialeve, veglave dhe proceseve të thjeshta teknologjike.

- Etika dhe kushtet e sigurta në shkollë dhe jashtë saj**

Nxënësit njihen me rreziqet që vijnë nga përdorimi i faqeve të ëeb-it të cilat nuk ofrojnë siguri të lartë për ta, dhe nuk publikojnë të dhëna personale që cenojnë sigurinë e tyre personale duke e demonstruar përmes veprimeve nevojën për realizimin e tyre në shtëpi, komunitet dhe shkollë sipas rregullave të sigurta.

## QASJA E BAZUAR NË KOMPETENCA

**Aftësitë njohëse:** Përcaktimi i problemeve dhe nevojave njerëzore, vëzhgimi, mbledhja e të dhënave, interpretimi i të dhënave të mbledhura, specifikimi i kërkesave që duhet të përmbushë produkti, zgjidhja e problemeve që lidhen me skicimin e produktit, shqyrtimi dhe vlerësimi i zgjidhjes, krahasimi, dallimi, analiza sipas kritereve dhe vendimmarrja e duhur.


**Aftësitë praktike:** Matja, markimi, prerja dhe dhënia e formave, bashkimi dhe montimi, ndërtimi dhe përfundimi; organizimi i zinxhirit të aktiviteteve në një sekuencë logjike.

**Aftësitë komunikuese:** Formulimi i ideve gjatë fazës së skicimit dhe në fazën e prezantimit të produktit përfundimtar; përgatitja e skicave, diagramave, modeleve dhe fotografive, si dhe skicat dhe grafikët me anën e kompjuterit.

Bazuar në këtë kurrikul, lënda “Aftësimit teknologjik” synon të përmbushë 3 kompetencat e lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçë, që duhet një nxënës t'i zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 3 tematikave kryesore.

TEKSTILET DHE MIRËMBAJTJA	MIRËMBAJTJA E MJEDISIT SHTËPIAK, KOPSHTIT	GATIMI DHE RUAJTJA E USHQIMEVE
<i>Aftësitë njohëse      Aftësitë praktike Aftësitë komunikuese</i>	<i>Aftësitë njohëse      Aftësitë praktike Aftësitë komunikuese</i>	<i>Aftësitë njohëse      Aftësitë praktike Aftësitë komunikuese</i>

Digrama 2; Kompetencat e lëndës “Aftësim teknologjik” dhe tematikat e fushës.



**Tabela 1; Kompetencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre**

<b>Kompetencat e lëndës “Aftësim teknologjik”</b>	<b>Përshkrimi i kompetencave</b>
<b>Komunikimi grafik</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Interpreton skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta teknike;</li> <li>Përdor mënyra të thjeshta të komunikimit grafik për të prezantuar ide dhe objekte të thjeshta teknike.</li> </ul>
<b>Strukturat dhe materialet teknologjike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdor materiale teknologjike kryesore, për realizimin e një produkti familjar;</li> <li>Realizon objekte ose produkte të ndryshme gjatë zbatimit të skicave, të modeleve dhe teknikave artizanale, duke përdorur një gamë të gjerë të mjeteve të materialeve dhe veglave të punës.</li> <li>Përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të thjeshta teknologjike;</li> <li>Shqyrton një gamë të gjerë të objekteve të jetës së përditshme;</li> <li>Eksploron se si një varg i formave, i objekteve dhe i strukturave të tjera mund të bëhen duke përdorur një shumëlojshmëri të materialeve me përmirësimë të mundshme.</li> </ul>

<b>Teknologja dhe veprimtaria ekonomike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerëson veprimtarinë dhe produktin përfundimtar, duke iu referuar planit të veprimit, recetës;</li> <li>• Kryen llogaritje të thjeshta të kostos së materialeve të produktit përfundimtar;</li> <li>• Përpunon materiale recikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtjeje dhe për ruajtjen e mjedisit.</li> </ul>
<b>Teknologja, sistemet teknologjike dhe bota e kompjuterit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon marrëdhënien e teknologjisë me sistemet teknologjike;</li> <li>• Mban qendrim kritik ndaj marrëdhënieς së teknologjisë me sistemet teknologjike për ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues.</li> <li>• Përdor mjete, përbajtje specifike, softëare dhe stimulimet për të mbështetur të nxënësit dhe kërkimin e informacionit.</li> </ul>

## 6. Ndarja e peshave për tematikë për secilën klasë

Lënda “Aftësimit teknologjik” zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë/javë **vetëm për klasën e gjashtë**. Programi specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që, përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore. Realizimi i programit sugjerohet të zhvillohet me nga 2 orë javore (90 min) të planifikuara së bashku, pra të zhvillohet një herë në dy javë, për t'i lënë nxënsve më shumë kohë në dispozicion për

realizimin e veprimitarive.

Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi në përbushjen e objektivave të linjave të veçanta, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë. Në program, për secilën klassë, afersisht 30-35 % e orëve mësimore totale janë menduar për ndërtimin e njohurive të reja lëndore dhe 65-70 % e tyre janë menduar për përforcimin e njohurive (gjatë dhe në fund të vitit shkollor).

**Tabela 2 Orë të sugjeruara për çdo tematikë**

	<b>TEKSTILET DHE MIRËMBAJTJA</b>	<b>MIRËMBAJTJA E MJEDISIT SHTËPIAK, KOPSHTIT</b>	<b>GATIMI DHE RUAJTJA E USHQIMEVE</b>	<b>Gjithsej orë</b>
<b>Klasa e gjashtë</b>	<b>10</b>	<b>10</b>	<b>15</b>	<b>35 orë</b>
<b>Klasa e shtatë</b>	-	-	-	-
<b>SHKALLA E TRETË</b>				<b>35 orë</b>

### **III. Përbajtja e shkallës së tretë**

Në programin lëndës “Aftësimit teknologjik” për shkallën e tretë janë paraqitur tematikat përbajtësore, të cilat përdoren për të

realizuar rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës/lëndës për shkallë të paraqitur në tabelë në fillim të çdo tematike.

**Përse cilën tematikë është përcaktuar grupi i njohurive për secilën klasë të shkallës së tretë (*klasa e gjashtë*).**

**Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demostrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle**

Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore përgjatë viti tshkollor duhet të zhvillohet e ndarë, referuar renditjes së sipas tematikave në program. Kombinimi dhe ndarja e koncepteve dhe shprehive, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve).

## 1. SHKALLA E TRETË

### Klasa e Gjashtë

#### 1.1 Tematika: GATIMI DHE RUAJTJA E USHQIMEVE

##### Përshkrimi i tematikës:

Nëpërmjet kësaj tematike nxënësi /ja eksploroni gamën e ushqimeve, mënyrat e përpunimit të tyre sipas vakteve për një ushqyerje të shëndetshme si dhe përgatit receta të thjeshta gatimi, gjithashtu realizon procedura të thjeshta të parapërgatitjes dhe përpunimit të lëndëve të para sipas recetës duke përdorur mjetet e punës dhe dekorojnë dhe shërbejnë asortimentin e gatuar.

##### Rezultatet e të nxënët për kompetencat e lëndës:

- Përzgjedh mjetet e punës dhe lëndët e para për gatimin tradicional të zonës sipas recetës;
- Realizon gatimin e asortimenteve tradicionale të zonës sipas recetave për një ushqyerje të shëndetshme;

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<b>NJOHURITË KLASA 6-të</b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>Menu</li><li>Menu e shëndetshme</li><li>Menu tradicionale</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>të shqyrtojnë menu tradicionale në trevat shqiptare.</li><li>të eksplorojnë përbërësit dhe mënyrat e gatimit të menuve tradicionale për një ushqyerje të shëndetshme.</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të prezantojnë raste konkrete të menusë tradicionale të zonës;</li> <li>• të planifikojnë përbërësit për realizimin e menusë tradicionale të zonës për një ushqyerje të shëndetshme;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlera ushqyese</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerëson vlerat ushqyese dhe koston e assortimenteve tradicionale të zonës për një ushqyerje të shëndetshme</li> </ul>

### Qëndrime dhe vlera

- Vlerëson materialet e përdorura, kohën për realizimin e vaktit dhe kostot përkatëse për një ushqyerje të shëndetshme.
- Vlerëson lëndët e para dhe ndihmëse të përdorura, mënyrën dhe kohën e gatimit dhe kostot përkatëse.
- Vlerëson individualisht dhe në grup shijen dhe paraqitjen estetike të assortimentit të gatuar sipas recetës për një ushqyerje të shëndetshme

## 2.2 Tematika: MIRËMBAJTJA E MJEDISIT SHTËPIAK, KOPSHTIT

### Përshkrimi i tematikës:

*Nëpërmjet kësaj tematike eksploroni objekte në mjedisin shtëpiak dhe në kopësht, kujdeset për kopshtin sipas stinëve si dhe ndërton objekte të tjeshta duke përdorur vegla dhe materiale të ndryshme, gjithashtu eksploroni mënyrat e arredimit të mjedisit shtëpiak, ndërtojnë skica*

*të theshta arredimi si dhe realizojnë mirëmbajtjen, pastrimin, dekorimin e tij.*

**Rezultatet e të nxenit për kompetencat e lëndës:**

- Evidenton mënyrat e mirëmbajtjes së pajisjeve elektro-shtëpiake.
- Përdor konkretisht pajisjet elektro-shtëpiake
- Zbaton rregulla të sigurisë gjatë përdorimit të pajisjeve elektoshtëpiake

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<b>NJOHURITË KLASA 6-të</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Pajisje elektro-shtëpiake</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Shqyrton një gamë të gjerë të pajisjeve të ndryshme në mjeshterin shtëpiak (pajisjet elektro- shtëpiale);</li><li>• Eksploroni mënyrat e përdorimit të pajisjeve elektro-shtëpiake sipas manualeve dhe instrukSIONEVE përkatëse;</li><li>• Heton irreziqet e mundshme nga përdorimi i pajisjeve elektro-shtëpiake dhe mënyrat e mbrojtjes nga to.</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Manualë përdorimi të pajisjeve elektro-shtëpiake</li><li>• Rregulla të sigurisë gjatë përdorimit të pajisjeve elektoshtëpiake</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Prezanton raste konkrete të përdorimit të pajisjeve elektro-shtëpiake;</li></ul>

## **Qëndrime dhe vlera**

- Vlerëson rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjesdit gjatë përdorimit të pajisjeve elektro-shtëpiake

### **2.3 Tematika: TEKSTILET DHE MIRËMBAJTJA**

**Përshkrimi i tematikës:** Nëpërmjet kësaj tematike nxënësi/sja eksploron lloje të ndryshme tekstilesh dhe mënyrën e tyre të thurjes si dhe realizojnë produkte të thjeshta përmes qepjes me dorë duke përdorur materialet dhe mjetet e duhura të punës, gjithashtu eksploron lloje të ndryshme materialesh konfekzioni, aksesorë dhe mënyrën e tyre të përdorimit si dhe realizon produkte të thjeshta përmes qepjes me dorë duke përdorur materialet e konfekzionit, aksesorë si dhe mjetet e duhura të punës. Nxënësi skicon kallëpe të thjeshta, përdor dhe realizon produkte të thjeshta me makinë qepëse shtëpiake si dhe hekuros dhe mirëmban konfekzionet.

#### **Rezultatet e të nxënët për kompetencat e fushës:**

- evidenton mënyrat e hekuroses së konfekSIONeve sipas përbërjes së tyre.
- Realizon qepjen sipas kallëpit të prerë;
- Realizon produkte të ndryshme me makinë qepëse familjare;

**Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës**

**Aftësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**

<p><b>NJOHURITË KLASA E GJASHTË</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Makina qepse familjare</li> <li>• Etiketat e konfeksioneve</li> <li>• Hekuri për hekurosje</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Eksploroni skica dhe kallëpe të gatshme për qepjet me makinë qepëse familjare (skica të çarçafëve, perdeve, shallave, veshjeve, etj.).</li> <li>• Shqyrton një gamë të produkteve për llojet qepjeve të realizuara me makinë qepëse familjare.</li> <li>• Dallon ndërtimin dhe funksionin e makinës qepëse familjare.</li> <li>• Përcakton llojet e detergjentëve që përdoren për mirëmbajtjen e tekstileve.</li> <li>• Interpreton etiketat e konfeksioneve të gatshme për mirëmbajtjen e tyre. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon ndërtimin dhe funksionin e hekurit për hekurosje në kushtet e shëpisë.</li> <li>• Hekuros konfeksione të ndryshme sipas përbërjes dhe treguesve të etiketës.</li> </ul> </li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Skicimi.</li> <li>• Prerja bazuar në kallëp;</li> <li>• Pastrimi i pëlhirave nga njollat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të listojnë materialet e nevojshme për realizimin e një produkti konkret me makinë qepse familjare</li> <li>• të skicojnë sipas kallëpit pëlhirën për qepjen me makinë qepse familjare</li> <li>• të presin sipas kallëpit pëlhirën për qepjen me makinë qepse</li> </ul>

	<p>familjare</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të planifikojnë kohën për realizimin e produkti dhe kostot përkatëse sipas skicës.</li> <li>• të përgatisin për punë makinën qepëse familjare.</li> <li>• të evidentojnë llojet e ndryshme të njollave dhe mënyrat e pastrimit të tyre;</li> <li>• Pastron njollat sipas llojit të tyre;</li> </ul>
--	---

#### **Qëndrime dhe vlera**

- Prezanton raste konkrete të qepjeve me makinë qepëse familjare të përdorimit vetjak dhe familjar.
- Vlerëson materialet e përdorura, kohën për realizimin e objektit dhe kostot përkatëse sipas planifikimit.

#### **IV. Udhëzime metodologjike**

Realizimi i programit kërkon përdorimin e metodologjive dhe teknikave që nxisin punën individuale, në grup dhe diskutimin e nxënësve në lidhje me kompetencat e parashtruara për çdo tematikë.

Në qendër të punës së mësuesit duhet të jetë drejtimi i nxënësve për të fituar **aftësi për të eksploruar, planifikuar, zbatuar dhe vlerësuar veprimtari konrete teknologjike** në varësi të tematikave të programit

Metodologjitet e mësimdhënies duhet të përbajnjë metoda, strategji dhe teknika që nxisin përdorimin e TIK-ut, nxisin përdorimin e prezantimit nga nxënësit për aftësimin praktik teknologjik.


Mësuesi gjatë shpjegimit të termave dhe demostrimit të veprimitarive praktike duhet të përdorë sa më shumë njohuritë dhe aftësitë e marra paraprakisht nga nxënësi në lëndë të tjera si dhe të japë shembuj nga realiteti i jetës.

Realizimi i tematikave të përbajtjes të programit:

- A. Tekstilet dhe mirëmbajtja;
- B. Mirëmbajtja e mjedisit shtëpiak, kopshtit;
- C. Gatimi dhe ruajtja e ushqimeve;

**Kërkon** nga mësuesi zbatimin e hapave metodologjikë, të cilat realizohen nëpërmjet fazave si:

**EKSPLORIMI - PLANIFIKIMI - ZBATIMI - VLERËSIMI.**



- Realizimi i fazës “*Eksplorimi*”, kërkon që nxënësit:
  - të shqyrtojnë një gamë të gjerë të objekteve të përditshme;
  - të eksplorojnë lirisht se si një varg i formave, objekteve dhe ndërtimeve të tjera, mund të bëhen duke përdorur një shumëlojshmëri të materialeve;
  - të shqyrtojnë se si disa objekte mund të përmirësohen apo përshtaten;
  - të ekplorojnë se si njerëzit pëlqejnë karakteristikat e caktuara të objekteve dhe të hetojë arsyet e këtyre preferencave. Preferencat në formë, ngjyrë, cilësi, strukturë, material;

- prakticiteti i përdorimit.
  - Realizimi i fazës “*Planifikimi*”, kërkon që nxënësit:
    - të përdorin njohuritë dhe rezultatin e hetimeve për të identifikuar nevojat dhe mundësitet për të përmirësuar një objekt ose mjediset në kontekste familjare. (p.sh., duke ditur se bimët kanë nevojë për ujë, mund të fillojë hartimin e pajisjes për ujitje, rezultatet e një sondazhi të mbeturinave, mund të nxisë bërjen e kazanëve të rinj të mbeturinave.);
    - të zhvillojnë aftësinë për të skicuar;
    - të prezantojnë skica, modele duke përdorur medie të ndryshme;
    - të organizojnë mjedisin, mjetet punën, duke marrë parasysh kufizimet e burimeve.
  - Realizimi i fazës “*Zbatimi*”, kërkon që nxënësit:
    - të realizojnë objekte dhe veprimtari të ndryshme;
    - të identifikojnë problematikën gjatë zbatimit të skicave, recetave, modeleve;
    - të zbatojnë teknikat artizanale gjatë realizimit të veprimtarive të ndryshme;
    - të përdorin një gamë të mjeteve, materialeve, veglave të punës.
  - Realizimi i fazës “*Vlerësimi*”, kërkon që nxënësit:
    - të vlerësojnë ndikimin pozitiv dhe negativ të punimit për vete dhe mjedisin përreth tij;
    - të diskutojnë qëndrueshmërinë, efikasitetin dhe formën e objekteve të tjera të realizuara;
    - të justifikojnë idetë, materialet, bashkimet, procedurat dhe teknikat e përdorura dhe të tregojë përmirësime të mundshme;
    - të vlerësojnë veprimtarinë dhe produktin përfundimtar duke iu referuar planit të veprimit, skicës, recetës apo modelit.
    - të kryejnë llogaritje të thjeshta të kostos së produktit përfundimtar.

### Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen e njohurive-bazë në lidhje me aspekte të aftësimit praktik teknologjik;
- integrimin e njohurive dhe aftësive të reja të një linje me njohuritë e linjave paraardhëse;
- integrimin e njohurive dhe aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (integrimi do të përshkojë zhvillimin e çdo ore mësimore);
- punët praktike të mbikqyrura apo të pavarura dhe projektet.

Orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mund të zhvillohen tema, veprimtari me nismën e mësuesit ose me kërkesën e vetë nxënësve.

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet *kohë e posaçme kultivimit* të:

- aftësive të përgjithshme si: komunikimi, transferimi i informacionit, të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimi i karakterit dhe i estetikës;
- aftësive për të eksploruar, planifikuar, zbatuar dhe vlerësuar veprimtaritetë konrete teknologjike të parashikuara në linjat e programit;
- aftësive të posaçme lëndore në lidhje me përdorimin e materialeve, mjeteve dhe veglave të thjeshta të punës, në lidhje me interpretimin e skicave, udhëzuesve të përdorimit, interpretimin e simboleve si dhe aftësive për të përgatitur produkte të ndryshme të parashikuara sipas linjave të programit;
- formimit të qëndrimeve, si: qëndrimi gjatë punës në grupe, gjatë punës individuale, mirëmbajtja e mjedisit dhe mjeteve të punës.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore ngajeta, etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është vlerësimi i realizimit të objektivave, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah shkallën e arritjeve të nxënësve.

## V. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së mësimit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqëndrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anë të dobëta dhe anë të forta të nxënësve në përbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demostrimin e aftësive teknologjike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*psh. vetvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, test objektiv, vëzhgim me një listë të plotë treguesish, portofol, prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj.*) Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjene materialeve duhen pasur parasysh:

- përcaktimii qëllimit dhei strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimitarive, që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimi qartë i qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim;
- vlerësimi u adresohet njohurive, shprehive e aftësive;
- reflekton besimin që të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;
- informacioni për rezultatet e vlerësimit duhet të motivojë nxënësin, të ndikojë që nxënësi të pranojë se gabimi është pjesë e të nxënësitet dhe të ndihmojë progresin e mëtejshëm;
- vlerësimi duhet të konsiderohet si pjesë e procesit mësimdhënie-nxënie dhe jo si veprimitari më vete;
- vlerësimi ndihmon nxënësit të marrin përgjegjësi për veten e tyre, duke përfshirë strategji të vetëvlerësimit, të vlerësimittë shokut me shokun;

- vlerësimi të jetë gjithëpërfsirës në kuptimin që t'u sigurojë të gjithë nxënësve të demonstrojnë arritjet e tyre dhe të arrijnë më të mirën e mundshme.

Vlerësimi si proces lidhet me tërësinë e metodave, praktikave dhe teknikave që përdorin mësuesit për të testuar, për të kontrolluar, analizuar dhe për të matur nivelin e njohurive, aftësive dhe të performancës së nxënësve. Vlerësimi duhet të jetë i realizueshëm, i vlefshëm, korrekt, i besueshëm dhe i saktë.

Vlerësimi duhet të japë një pasqyrë për arritjet e nxënësit, si edhe vështirësitë që mund të kenë nxënësit gjatë realizimit të detyrave ose projekteve kurrikulare. Të vlerësosh nxënësit nuk do të thotë vetëm t'i vendosësh atij një notë, por edhe ta ndihmosh atë të kalojë vështirësitë gjatë arritjes së kompetencave. Vlerësimi në klasë luan një rol të rëndësishëm në mënyrën se si mësojnë nxënësit, në motivimin e tyre për të nxënë dhe në mënyrën e shpjegimit të mësuesit. Pyetjet që lidhen me cilësinë (besueshmërinë, burimet e referencës, vlefshmërinë) janë të rëndësishme për të gjitha llojet e vlerësimit në klasë.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të ndihmohen nxënësit të bëhen autonomë dhe të janë në gjendje të vetëvlerësojnë progresin e tyre.

Vlerësimi bëhet në atë çka nxënësit kanë përvetësuar dhe janë të aftë të bëjnë. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Mësuesit nuk e kanë të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore. Në paragrafin në vijim do të gjeni disa forma vlerësimi të cilat ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë vështirësitë e tyre.

#### a. **Vlerësimi formues**

Ky lloj vlerësimi duhet të realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga mësuesi/ja, në mënyrë që të kuptohen vështirësitë e nxënësve, më pas të shihet ecuria e tyre dhe në fund të kapitullit të shihet nëse janë arritur kompetencat e kërkua. Për nxënësit e ciklit të mesëm të ulët, ky vlerësim është shumë i rëndësishëm pasi ata fillojnë të analizojnë në mënyrë të thelluar atë çfarë ata janë në gjendje të arrijnë dhe ta përdorin si pikën e tyre të fortë. Gjatë këtij vlerësimi, mësuesi/ja duhet të vëzhgojë herë pas here nxënësit, të realizojë

bashkëbisedime me ta, të realizojë produkte të ndërmjetme para produkteve finale. Ky lloj vlerësimi i ndihmon nxënësit të gjejnë mënyrën e duhur për të mësuarin efektiv.

### **b. Vlerësimi nëpërmjet portofolit**

Një formë tjetër vlerësimi është edhe *vlerësimi nëpërmjet portofolit*, është një formë që e ndihmon nxënësin të shohë se si ai avancon hap pas hapi. Portofoli i nxënësit është një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, i cili përmban një koleksion punimesh që ai organizon përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përbajë detyra shtëpie me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografji e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi/ja është në rolin e atij që drejton dhe rekomandon. Qëllimi kryesor i portofolit është që nxënësi/ja të koleksionojë ato dokumente që atij mund t'i shërbijnë në vitet në vijim. Gjithashtu, në portofol, nxënësi/ja mund të shohë se si ai/ajo përparon nga muaji në muaj ose nga semestri në semestër.

### **c. Vetëvlerësimi**

Ku lloj vlerësimi është gjykimi që secili nxënës jep për arritjet e tij. Vetëvlerësimi shpesh shërben si një plotësues i domosdoshëm i teknikave të vlerësimit, të bëra nga mësuesi/ja dhe nga provimet. Pika e fortë e vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është një faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënënit e tyre. Duhet theksuar që vetëvlerësimi është më i vlefshëm dhe më objektiv nëse nxënësit i jepen kriterë të sakta mbi të cilat ai/ajo bën vetëvlerësimin e punës së tij/saj. *P.sh.: mund t'i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetëkorrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta dhe, më pas, ai/ajo ta integrojë korrigjin në veprimtarinë e kërkuar.*

Vlerësimi i nxënësit mund të bëhet në mënyrë individuale ose në grup. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstron arritjet e tij me gojë, me shkrim apo nëpërmjet veprimtarive të tjera.

Nxënësi vlerësohet për portofolin e detyrave, për prezantimet, vëzhgimet e realizuara në përputhje me detyrat standarde të përcaktuara nga mësuesi.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi duhet t'u parashtrojë nxënësve qëllimin, kriteret dhe instrumentet e vlerësimit.

Çrregullime të diagnostikuara si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të nxënësve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.

## VI. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Për arritjen me sukses të kompetencave në fushën e TIK-ut dhe Teknologjisë është e rëndëesishme të përdoren materiale dhe burime mësimore që japid një informacion të kuptueshëm për moshën e nxënësit dhe që i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësi, shkaktësi, njoħuri dhe qëndrime që u nevojiten atyre për të mësuarin gjatë gjithë jetës. Njëri nga burimet e thjeshta mësimore dhe që përdoret shpesh nga nxënësit dhe mësuesit është teksti mësimor. Mirëpo me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe të shtimit të informaciot digjital, mësuesi duhet ta shoh tekstin më tepér si një burim nxitës por jo të mjaftueshëm për të zhvilluar kompetencat kyçe tek nxënësit.

Mësuesit mund të bashkëpunojnë online me mësuesit të shkollave të tjera për të gjetur burime të besueshme informacioni, që i vijnë në ndihmë jo vetëm nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre por edhe mësuesve për të zhvilluar një qasje të re metodike. Nëpërmjet rritjes së shumë llojshmërisë së burimeve ne nxisim më shumë nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik, krijues dhe problem zgjidhës gjatë procesit mësimor.

Disa nga burimet që mund të përdoren nga mësuesit për zhvillimin e orës mësimore mund të janë: bibliotekat elektronike, broshurat informuese apo ndërgjegjësuese, enciklopeditë, softëare elektronik në funksion të mësimdhënies/mësimnxënies, studimet

shkencore me fokus tek Teknologja dhe TIK-u, etj...

Gjithashtu në bashkëpunim me nxënësit dhe shkollat mund të organizohen seminare të ndryshme mësimore dhe punimet më të mira të publikohen dhe tu vihen në dispozicion të gjitha shkollave. Në ditët e sotme, ndodh shpesh që nxënësit të jetë një hap përpara mësuesit për sa i përket informacioneve elektronike, në këtë mënyrë mësuesit mund të krijojnë forume mësimore bashkë me nxënësit për të krijuar materiale në ndihmë të procesit mësimor.

---

**KOORDINATOR I PROGRAMIT:**

EDLIRA SINA, MEZINI-IZHA

[edlirasina@yahoo.com](mailto:edlirasina@yahoo.com)